



PËRGATITJA E STRATEGJISË SË OJQ-SË ACDC 2021-2025

Më 13 janar 2021, ekipi i Qendrës Avokuese të Kulturës Demokratike (ACDC) zhvilloi një punëtori ku u prezantuan rezultatet e reja dhe të rishikuara të të gjitha aktiviteteve të projektit gjatë vitit të kaluar, një draft strategji për 2021-2025 dhe një analizë SWOT të organizatës dhe aktiviteteve të saj.

Gjatë analizës SWOT, u rinovuan pikat e forta të organizatës, u identifikuan pikat e dobëta, janë identifikuan kërcënimet dhe u vlerësua se ka hapësirë të mjaftueshme për arritje të reja në periudhën e ardhshme.

EMISIONE TV

INTEGRIMI I DREJTËSISË DHE FUNKSIONIMI GJATË PANDEMISË COVID-19

Më 14 janar 2021, gjykatësi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Millosh Marković dhe ndihmësi i projektit të OJQ-së ACDC, Millan Smikić, folën për integrimin e gjyqësorit dhe funksionimin e gjykatave në veri të Kosovës gjatë pandemisë COVID-19.




Dušan Radaković ACDC


EMISIONE TV

PROMOVIMI I PROJEKTIT 14.01.2021

Drejtori Ekzekutiv i OJQ ACDC, Dushan Radaković dhe Drejtori i Programit të OJQ ACDC, Aca Mitiq, folën për projektin "Përmirësimi i Transparencës dhe Sundimit të Ligjit në Komunitet me shumicë Serbe", i cili u mbështet nga INL.




Aca Mitiq programski direktor ACDC




OP-ED PREDRAG MILJKOVIC 15.01.2021

Avokati, Predrag Miljkovic, shkroi OP-ED-in me temën "Sfidat dhe vështirësitë e praktikës ligjore në Kosovë" dhe vuiri në dukje disa probleme në lidhje me sistemin ligjor në Kosovë. Një nga problemet e zjarra të praktikës juridike, sic u shpreh z. Miljkovic, është harmonizimi i përkthimeve të ligjeve dhe akteve nënligjore në serbisht dhe shqip. Përveç kësaj, z. Miljkovic përmendi si problem ekzistencën dhe punën e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) dhe Agjencisë së Kosovës për Krahasimin dhe Verifikimin e Pasurive, si dhe nevojën për të krijuar të paktën një ose dy departamente të tjera të Gjykatës Administrative në Kosovë, për të rritur efikasitetin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative.



WEBINAR



WEBINAR ME AVOKATË TË RINJ NGA VERIU I KOSOVËS - SHKELZEN MALIQI

Datë 20.01.2021 – OJQ ACDC organizoi një uebinar me Drejtorin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Skelzen Maliqi, me temën "Roli dhe Rëndësia e Këshillit Gjyqësor të Kosovës" dhe foli për funksionimin e Këshillit Gjyqësor, dhe gjithashtu preku temën e Provimit të Jurisprudencës. Webinar-i u ndoq nga 25 jurist të diplomuar dhe studentë, webinar-i zgjati një orë dhe dhjetë minuta.




TAKIMI I KOALICIONIT - CLARD-KLI-ACDC

Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC) priti një takim koalicionin e organizatave të shoqërisë civile - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), Qendra për Ndhimën Ligjore dhe Zhvillimin Rajonal (CLARD) dhe përfaqësuesit e Qendrës Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC). Ky koalicion është rezultat i një partneriteti të financuar nga Byroja Ndërkombëtare e Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit (INL), e cila në periudhën e ardhshme do të zbatojë intensivisht aktivitetet që synojnë forcimin e sundimit të ligjit dhe sigurimin e qasjes në drejtësi përmes një programi të ndihmës juridike falas në veriun e Kosovës.

WEBINAR "NGA TRAJNIMI TEK AVOKATI" 28.01.2021

Ligjëruesi i ftuar në uebinar ishte Z. Predrag Miljkovic. Z. Miljkovic ushtron profesionin e avokatit dhe siguron ndihmë juridike falas që nga Prilli i vitit 2019, pasi kaloi provimin e jurisprudencës ai filloi praktikën juridike në mënyrë të pavarur dhe themeloi Zyrën e Avokatisë "Miljkovic" në Mitrovicën e Veriut. Webinar-i kishte për qëllim informimin e avokatëve të rinj për mënyrën se si funksionon praktika në zyrën e avokatisë, si të përgatitemi për provimin e jurisprudencës, si të fitojmë aftësitë e nevojshme juridike si dhe mundësitë për punë praktike dhe punësim, në përputhje me masat e veçanta për shkak të Covid 19. Webinar-i u ndoq nga 22 të rinj dhe uebinari zgjati pak më shumë se një orë.



PARAQITJA

PARAQITJA E DUAKAN RA-DAKOVIC - I FTUAR NË RADIO KONTAKT PLUS

Më 29 janar 2021, drejtori ekzekutiv i OJQ-së ACDC ishte mysafir në radio Kontakt plus, ai foli për zgjedhjet e ardhshme.



OP-ED MARKO MILENKOVIC 31.01.2021

Menaxheri i Programit në OJQ-së, Nisma e Re Sociale (NSI), Marko Milenkovic, shkroi OP-ED-in me temën "Pjesëmarrja e Qytetarëve në Proceset e Vendimmarrjes në Kosovë". Z. Milenkovic theksoi: "Pavarësisht nga drejtimi i situatës politike dhe zgjidhja e problemit të Kosovës, komuniteti serb në Kosovë ka nevojë për institucione që ofrojnë shërbime efektive dhe cilësore për qytetarët, prandaj është thelbësore që të ketë qeveri lokale efektive, si dhe institucione të tjera publike". Me atë rast, u formuan katër platforma në internet të E-komunës, të cilat u mundësojnë qytetarëve të informohen për lajmet e rëndësishme në katër qeveri lokale në veri të Kosovës, qasjen në dokumentet publike dhe strukturën organizative të komunave, si dhe pjesëmarrja përmes sistemit 'Pyet Kryetarin e Komunës' dhe sistemin 48 Orësh.

